



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.15

17 shkurt

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.75, datë 28.1.2008	Për përdorimin e bonove të privatizimit të punonjësve të ish-shoqërisë “Prodhim asbesti”, sh.a. Vlorë, nga “Paketa e aksioneve për punonjësit” në “Paketa e aksioneve për publikun”	521
Vendim i KM nr.76, datë 28.1.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit”, të ndryshuar.....	521
Vendim i KM nr.77, datë 28.1.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”, të ndryshuar	522
Vendim i KM nr.78, datë 28.1.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë, të Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës dhe Administratën e Presidentit, të Kuvendit dhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”, të ndryshuar	523
Vendim i KM nr.79, datë 28.1.2008	Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës	524
Vendim i KMBSH nr.11, datë 6.2.2008	Për miratimin e rregullores “Për instrumentet e pagesave elektronike”	528

VENDIM
Nr.75, datë 28.1.2008

PËR PËRDORIMIN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT TË PUNONJËSVE TË ISH-SHOQËRISË “PRODHIM ASBESTI”, SHA VLORË, NGA “PAKETA E AKSIONEVE PËR PUNONJËSIT” NË “PAKETA E AKSIONEVE PËR PUBLIKUN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, dhe të nenit 7 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rezultatet e llogaritjes së paketës së aksioneve për punonjësit e ish-shoqërisë “Prodhim asbesti”, sh.a., Vlorë, të shërbejnë vetëm për efekt të listës emërore, me vlerat përkatëse, të investuara nga secili aksionar, për t’u përfshirë në “Paketa e aksioneve për publikun”, në shoqëritë anonime, të përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Pika 1.2 e urdhrin nr.314, datë 31.8.1998 të Ministrit të Ekonomisë dhe Privatizimit “Për fillimin e procedurave të privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, shfuqizohet.

3. Publikimi i procedurave të privatizimit, sipas urdhrin të sipërpërmendur, për transferimin e 16,6 për qind të paketës së aksioneve për punonjësit e ish-shoqërisë “Prodhim asbesti”, sh.a. Vlorë, anulohet.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.76, datë 28.1.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.371, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Lidhja nr.3, që i bashkëlidhet vendimit nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
Lidhja nr.3

Pozicioni	Kualifikimi/grada/titulli shkencor	Shtesa (lekë/muaj)
Titullar i institucionit	Profesor	30 000
	Profesor i asociuar	25 000
Zv/titullar i institucionit Drejtor drejtorie në institucion	Doktor i shkencave	20 000
	Doktor i shkencave	25 000
Përgjegjës sektori Anëtar i organit drejtues Specialist	Studime të thelluara pasuniversitare/Master i nivelit të dytë. Studime specializuese afatgjata	10 000
	Studime të thelluara pasuniversitare/Master i nivelit të dytë	20 000

Shënim: Vlerat 20 000 lekë, për diplomat “Master i nivelit të dytë/Studime të thelluara pasuniversitare” dhe 25 000 lekë, për gradën shkencore “Doktor i shkencave”, aplikohen për nëpunësit/titullarët, që i kanë përfituar diplomat përkatëse në universitetet, apo shkollat e larta të vendeve të përcaktuara sipas listës që do t’i bashkëlidhet udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Minsitrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike (pika 6 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.476, datë 18.7.2007).

VENDIM
Nr.77, datë 28.1.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5.1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Lidhja nr.5, që i bashkëlidhet vendimit nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Pozicioni	Kualifikimi/grada/titulli shkencor	Shtesa (lekë/muaj)
Titullar i institucionit	Profesor	30 000
	Profesor i asociuar	25 000
Zv/titullar i institucionit Drejtor Drejtorie në institucion. Anëtar i organit drejtues.	Doktor i shkencave	20 000
	Doktor i shkencave	25 000
Përgjegjës Sektori. Menaxher trajnimi. Specialist.	Studime të thelluara pasuniversitare/Master i nivelit të dytë. Studime specializuese afatgjata	10 000
	Studime të thelluara pasuniversitare/Master i nivelit të dytë	20 000

Shënim: Vlerat 20 000 lekë, për diplomat “Master të nivelit të dytë/Studime të thelluara pasuniversitare” dhe 25 000 lekë, për gradën shkencore “Doktor i shkencave”, aplikohen për nëpunësit/titullarët, që i kanë përfituar diplomat përkatëse në universitet, apo shkollat e larta të vendeve të përcaktuar sipas listës që do t’i bashkëlidhet udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike (pika 14 e këtij vendimi).

VENDIM
Nr.78, datë 28.1.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.475, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË, TË ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE,
NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E
PRESIDENTIT, TË KUVENDIT DHE NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Lidhja nr.4, që i bashkëlidhet vendimit nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2008.

Pozicioni	Kualifikimi/grada/titulli shkencor	Shtesa (lekë/muaj)
Zëvendësministër	Profesor	30 000
Drejtor i Kabinetit të Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit/Zëvendëskryeministrit	Profesor i asociuar	25 000
Këshilltar i Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit/Zëvendëskryeministrit		
Ndihmës i Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit		
Sekretar i Përgjithshëm		
Ndihmës i Zëvendëskryeministrit	Doktor i shkencave	20 000
Drejtor Kabineti i Ministrit		
Këshilltar i Ministrit		
Drejtor Departamenti	Doktor i shkencave	25 000
Drejtor i Përgjithshëm		
Drejtor		
Përgjegjës sektori	Studime të thelluara pasuniversitare/Master i nivelit të dytë.	10 000
Kryeinspektor	Studime specializuese afatgjata	
Koordinator		
Jurist		
Inspektor	Studime të thelluara pasuniversitare/Master i nivelit të dytë	20 000
Specialist		

Shënim: Vlerat 20 000 lekë, për diplomat “Master i nivelit të dytë/Studime të thelluara pasuniversitare” dhe 25 000 lekë, për gradën shkencore “Doktor i shkencave”, aplikohen për nëpunësit civilë dhe funksionarët politikë, që i kanë përfituar diplomat përkatëse në universitetet, apo shkollat e larta, të vendeve të përcaktuara sipas listës që do t’i bashkëlidhet udhëzimit të përbashkët, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike (pika 11 e këtij vendimi).

VENDIM
Nr.79, datë 28.1.2008

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E NDËRMJETËSVE NË SIGURIME DHE TË RREGULLAVE PËR MBIKËQYRJEN E VEPRIMTARISË SË TYRE, SI DHE RASTET E REFUZIMIT TË LICENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 77 pika 10, e 81 pika 2 e ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Të përgjithshme

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare licencon dhe mbikëqyr veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime për agjentë, shoqëri agjentësh, brokera dhe shoqëri brokerimi, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim.

2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime është:

- e përcaktuar sipas klasave të sigurimit;
- e patransferueshme;
- e patregtueshme;
- me afat 3 vjet, me të drejtë rinovimi, përjashtuar shoqëritë e brokerimit.

II. Kriteret për licencimin e veprimtarisë së brokerimit

1. Veprimtaria e brokerimit përfshin:

a) veprimtarinë e paraqitjes, të propozimit apo kryerjes së punës përgatitore, për nënshkrimin e kontratave të sigurimit ose risigurimit;

b) analizën e rreziqeve në sigurime;

c) dhënien e shpjegimeve dhe të këshillave për kushtet, afatet, kufizimet apo përjashtimet e kontratës dhe të primit të sigurimit ose risigurimit;

ç) dhënien e ndihmesës në ushtrimin e të drejtave, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, në veçanti, në shlyerjen e detyrimeve nga shoqëritë e sigurimit.

2. Personi fizik, i cili kërkon të pajisjet me licencë për të kryer veprimtari brokerimi në sigurime, duhet të plotësojë këto kriteret:

a) të ketë diplomë të shkollës së lartë;

b) të ketë përvojë profesionale në fushën e sigurimeve ose kualifikime të vërtetuara me certifikatë, në programe të njohura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

c) të kalojë me sukses testin për njohuritë e fushës, sipas përcaktimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

ç) të plotësojë kriteret e mëposhtme të besueshmërisë:

i) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

ii) të mos jetë dënuar për ndonjë veprë, që përbën arsye për refuzim licence, si: vepra kriminale ndaj pronës, vepra të krimit ekonomik, veprimtari të jashtëligjshme gjatë 10 viteve të fundit, para datës së kërkesës për licencë;

iii) të mos ketë detyrime të papaguara në afat;

iv) të mos jetë i punësuar në ndonjë shoqëri sigurimi;

v) të mos ketë qenë anëtar i këshillave mbikëqyrëse apo drejtues i shoqërive në proces falimentimi a likuidimi, gjatë 5 viteve të fundit.

Plotësimi i kërkesave sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike vërtetohet me dokumentacionin përkatës.

3. Personi juridik, i cili kërkon të pajiset me licencë për të kryer veprimtari brokerimi në sigurime, duhet të plotësojë këto kriteret:

a) të jetë i regjistruar si shoqëri;

b) të mos ketë detyrime të papaguara në afat;

c) të ketë të punësuar, të paktën, një broker të licencuar.

Drejtori i Përgjithshëm dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës duhet të plotësojnë kërkesat sipas pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi.

4. Kërkesa, me shkrim, drejtuar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për pajisjen me licencë brokerimi, shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentin me të dhënat identifikuese për personin fizik apo juridik;

b) kërkesën për fushën e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime, sipas klasave të sigurimit, dhe territori, ku do të kryhet kjo veprimtari;

c) deklaratën për datën, kur do të fillojë veprimtaria e ndërmjetësimit;

ç) dokumentin bankar, që vërteton depozitimimin e kapitalit minimal, vetëm për personin

juridik;

d) policën e sigurimit për përgjegjësi profesionale, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, për personin juridik;

dh) dokumentin, që vërteton se personi fizik apo juridik disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime;

e) dokumentin se ka punësuar broker, të pajisur me licencë, si dhe vendimin e regjistrimit të personit juridik, statutin dhe aktin e themelimit të personit juridik.

III. Veprimtaria e agjentit në sigurime

1. Veprimtaria e agjentit në sigurime ushtrohet nga persona fizikë dhe shoqëri agjentësh, të licencuar më përputhje me kërkesat e këtij vendimi, si dhe nga ente të tjera, që kryejnë veprimtari në fushën:

a) bankare;

b) e shërbimeve financiare;

c) e shërbimit postar;

ç) e shërbimit si agjenci udhëtimi;

d) e shërbimit si agjenci imobiliare;

dh) e shërbimit si zyrë e këmbimit valutor,

me kusht që veprimtaria e agjentit në sigurime të ushtrohet në emër të tyre, nga agjentë të licencuar në sigurime.

2. Komisioni për kryerjen e veprimtarisë së agjentit paguhet nga shoqëria e sigurimeve dhe përcaktohet në kontratën e agjentit.

3. Për arkëtimin e primeve, për llogari të shoqërisë së sigurimit, agjenti përdor një llogari bankare të veçantë, të hapur për këtë qëllim dhe të ndarë veçmas nga llogaria e tij e biznesit.

4. Agjenti në sigurime, gjatë të gjithë periudhës, që kryen veprimtarinë e ndërmjetësimit, duhet të ketë sigurim përgjegjësie profesionale ndaj palëve të treta, kundrejt dëmeve të shkaktuara nga kryerja e veprimtarisë, në një shumë jo më të vogël se 100 000 lekë, për çdo ngjarje të siguruar, ose jo më të vogël se 150 000 lekë në vit, për të gjitha rastet e sigurimit.

5. Agjenti në sigurime detyrohet të ketë, në mënyrë të vazhdueshme, një garanci financiare, në masën 4 për qind të shumës së primeve vjetore të mbledhura ose të paktën shumën 500 000 lekë, kur është person fizik, dhe të paktën shumën 1 000 000 lekë, kur është person juridik, të vëna si garanci për llogari të shoqërisë së sigurimit. Garancia financiare depozitohet në njërin nga bankat e nivelit të dytë, që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në emër të shoqërisë së sigurimit, për të cilën do të veprojnë.

IV. Kriteret për licencimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime

1. Personi fizik, i cili kërkon të pajiset me licencë, për të kryer veprimtari si agjent në sigurime, duhet të plotësojë këto kritere:

a) të ketë të paktën diplomë të shkollës së mesme;

b) të ketë përvojë profesionale ose dëshmi për kryerjen e një kualifikimi pranë një instituti trajnimi në sigurime, të njohur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

c) të ketë dëshminë për njohuritë bazë në përdorimin e kompjuterit;

ç) të ketë kontratë me shoqërinë e sigurimit, në emër dhe për llogari të së cilës do të veprojnë;

d) të plotësojë kriteret e mëposhtme të besueshmërisë:

i) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

ii) të mos jetë dënues për ndonjë veprë, që përbën arsye për refuzim licence si: vepra kriminale ndaj pronës, vepra të krimit ekonomik, veprimtari të jashtëligjshme;

iii) të mos ketë detyrime të papaguara në afat;

iv) të mos jetë i punësuar në ndonjë shoqëri sigurimi;

v) të mos ketë qenë anëtar i këshillave mbikëqyrëse apo drejtues i shoqërive në proces falimentimi a likuidimi.

Plotësimi i kërkesave sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të kësaj pike, vërtetohet me dokumentacionin përkatës.

2. Personi juridik, i cili kërkon të pajiset me licencë për të kryer veprimtari si agjent në

sigurime, duhet të plotësojë këto kritere:

- a) të jetë i regjistruar si shoqëri;
- b) të mos ketë detyrime të papaguara në afat;
- c) të ketë të punësuar, të paktën, një agjent të licencuar.

Drejtori i përgjithshëm dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës duhet të plotësojnë kërkesat sipas shkronjës “d”, të pikës 1, të kreut IV, të këtij vendimi.

3. Shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të së cilës do të veprojë agjenti apo shoqëria e agjentëve, për t'u pajisur me licencë agjenti, i dërgon një kërkesë, me shkrim, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

4. Kërkesa për pajisjen me licencë agjenti shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) dokumentin me të dhënat identifikuese për personin fizik apo juridik;
- b) kërkesën për fushën e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime, sipas klasave të sigurimit, dhe territori, ku do të kryhet kjo veprimtari;
- c) dokumentin bankar, që vërteton depozitimin e garancisë financiare në emër të shoqërisë së sigurimit, për të cilën do të kryejë veprimtarinë e agjentit në sigurime;
- ç) policën e sigurimit për përgjegjësi profesionale, gjatë ushtrimit të veprimtarisë;
- d) dokumentin, që vërteton se disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme, për të ushtruar veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime, përfshirë edhe instalimin e sistemit të informatizimit të raportimit të të dhënave me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe shoqërinë e sigurimit, për llogari të të cilit punon;
- dh) dokumentin se ka punësuar agjent të pajisur me licencë, si dhe vendimin e regjistrimit të personit juridik, statutin dhe aktin e themelimit të personit juridik.

5. Shoqëria e huaj e ndërmjetësimit, që nëpërmjet degës së saj, kërkon të ushtrojë veprimtari ndërmjetësimi në sigurime në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të paraqesë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare:

- a) miratimin zyrtar për hapjen e kësaj dege, dhënë nga Autoriteti Mbikëqyrës i vendit të origjinës;
- b) çdo informacion tjetër, të parashikuar në ligj, në këtë vendim për personin juridik dhe që kërkohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

V. Procedura të shqyrtimit të dokumentacionit për licencim

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi për licencë. Nëse në dokumentacion vërehen mangësi apo pasaktësi, kërkuesi njoftohet për plotësimin e tyre, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.

2. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, brenda 30 ditëve, kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit të plotë nga kërkuesit për licencë, jep ose refuzon licencën për ushtrim veprimtarie, si ndërmjetës në sigurime.

3. Për pajisjen me licencë, ndërmjetësi në sigurime paguan, për llogari të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, një komision, të përcaktuar sipas vendimit nr.403, datë 9.6.2005 të Këshillit të Ministrave.

4. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miraton formularin e kërkesës dhe formatin e licencës.

VI. Refuzimi i licencës

1. Personit, i cili kërkon të pajiset me licencë, i refuzohet licenca nëse:

- a) nuk përmbush kërkesat, në zbatim të këtij vendimi;
- b) nuk kalon me sukses testimin për njohuritë, sipas pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi;
- c) ka kryer shkelje të kuadrit ligjor në fushën e sigurimeve.

VII. Mbikëqyrja e veprimtarisë

1. Mbikëqyrja e subjekteve të licencuara për veprimtari ndërmjetësimi kryhet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, nëpërmjet raportimeve periodike të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar nga ky autoritet, si dhe të inspektimit në vend.

2. Subjekti i licencuar për veprimtari ndërmjetësimi në sigurime detyrohet të mbajë inventarin e saktë të policave të sigurimit, të dhëna nga shoqëria e sigurimit, të ndara sipas klasave

të sigurimit, kategorive dhe të dhënave të tjera identifikuese dhe ta paraqesë atë gjatë kontrollit të ushtruar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

3. Subjekti i licencuar për veprimtari agjenti në sigurime kryen aktrakordimin e policave të shitura, së bashku me mandatin e bankës, me shoqërinë e sigurimit, 1 herë në javë.

4. Ky aktrakordim mbahet ndarazi për policat e shitura, sipas monedhave.

5. Subjekti i licencuar për veprimtari ndërmjetësimi detyrohet:

a) të ushtrojë veprimtarinë me profesionalizëm, kujdes dhe përkushtim ndaj konsumatorëve;
b) të veprojë me mirëbesim dhe ndershmëri për respektimin e të drejtave të konsumatorit;
c) të informojë të siguarin për produktet e sigurimit, kushtet, e përgjithshme e të veçanta, të kontratave të sigurimit, përfitimet, që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, tarifatat dhe primet, që i siguruari duhet të paguajë.

VIII. Transparenca dhe konfidencialiteti

1. Brokerat dhe agjentët, gjatë veprimtarisë së tyre, kanë detyrimin të zbatojnë parimin e pjesëmarrjes vullnetare në lidhjen e kontratave të sigurimit.

2. Subjekti i licencuar për veprimtari ndërmjetësimi në sigurime duhet të jetë lehtësisht i identifikueshëm nga publiku. Ai detyrohet të japë, minimalisht, këtë informacion:

a) emrin, mbiemrin dhe adresën, ku ushtron veprimtarinë;

b) dokumentin, që vërteton se është i licencuar për të ushtruar veprimtari ndërmjetësimi në sigurime;

c) shoqërinë e sigurimit, për llogari të së cilës vepron;

ç) afatin e vlefshmërisë së licencës.

Ky informacion duhet të jetë i dallueshëm, i qartë, i saktë dhe i kuptueshëm nga konsumatori dhe të përfshihet në shenjën dalluese të çdo ndërmjetësi të licencuar në sigurime, që mbahet gjatë të gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë.

3. Ndërmjetësit në sigurime janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, të fakteve dhe rrethanave, që kanë të bëjnë me të siguarit, dhe të të dhënave, me të cilat njihen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

4. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare boton listën e përditësuar të ndërmjetësve të licencuar, të paktën një herë në 6 muaj, sipas rregullave të përcaktuara prej tij.

IX. Të fundit

Vendimi nr.192, datë 25.3.2005 i Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe kriteret e licencimit të agjentëve në sigurime, si dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre”, shfuqizohet.

X. Ngarkohet Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIMI

Nr.11, datë 6.2.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR INSTRUMENTET E PAGESAVE ELEKTRONIKE”

KREU I TË PËRGJITHSHME

**Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:

1. Standardeve të transparencës ndaj klientit lidhur me kushtet, rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave nëpërmjet instrumenteve të pagesave elektronike në Republikën e Shqipërisë;
2. Llojeve të instrumenteve të pagesave elektronike në Republikën e Shqipërisë; si dhe
3. Mënyrës së mbrojtjes dhe raportimit të informacionit gjatë përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike.

Neni 2

Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe në përputhje me:

- a) ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b) ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;
- c) rregulloren “Për sistemin dhe instrumentet e pagesave”;
- d) rregulloren “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”; dhe
- e) akte të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Subjekte të zbatimit të kësaj rregulloreje janë bankat dhe/ose degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen në rastet e mëposhtme:
 - a) pagesave me çek, kambial, si dhe çdo lloj mjeti tjetër pagese me bazë letër (*paper-based*);
 - b) instruksioneve të pagesave elektronike të iniciuara nga bankat, për kryerjen e pagesave të ndërsjella në sistemet ndërbankare të shlyerjes.

Neni 4

Përkufizime

1. Në zbatim dhe për efekt të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
 - a) Pagesë elektronike – është transaksioni i pagesës, i realizuar nëpërmjet një karte që përmban një shirit magnetik, një mikroqark ose një kod identifikues dhe që përdoret në një terminal pagesash elektronike, në një terminal pikëshitjeje POS etj.; apo nëpërmjet një aplikacioni bankar duke përdorur mjete elektronike të komunikimit.
 - b) Instrument i pagesave elektronike (IPE) – është instrumenti që i mundëson mbajtësit të kryejë pagesa elektronike. Këtu përfshihen si instrumentet e pagesave me akses në distancë, ashtu edhe instrumentet e parasë elektronike.
 - c) Instrument i pagesave me akses në distancë – është një instrument, që i mundëson mbajtësit të aksesojë fondet në llogarinë e tij në një bankë, zakonisht nëpërmjet numrit të identifikimit personal dhe/ose mjeteve të tjera të identifikimit. Këtu përfshihen kartat bankare dhe shërbimet e tjera elektronike bankare.
 - d) Karta bankare - është instrumenti i pagesës elektronike, i emetuar nga një bankë e licencuar për të zhvilluar transaksione bankare me funksione të parapërcaktuara.
 - e) Shërbime të tjera elektronike bankare – janë shërbimet bankare të realizuara online si: *home banking*, *phone banking*, *internet banking* etj., që kryhen nëpërmjet mjeteve elektroteknike të komunikimit.
 - f) *Home banking* - është një shërbim, që lejon mbajtësin të realizojë transaksione të ndryshme bankare, përfshirë urdhërpagesat, duke përdorur kompjuterin e tij me lidhje online me bankën, me anë të një linje telefonike pa përdorur internetin.
 - g) *Phone banking* - është një shërbim që lejon mbajtësin të përdorë telefonin për të realizuar transaksione të ndryshme bankare, përfshirë mundësinë për të bërë urdhërpagesa nga një llogari bankare.

h) *Internet banking* – është një shërbim, që lejon mbajtësin të realizojë transaksione të ndryshme bankare, përfshirë urdhërpagesat, duke përdorur internetin.

i) Instrument i parasë elektronike – është një instrument pagese, i ndryshëm nga instrumenti i pagesave në distancë, i cili ruan vlera monetare në formë elektronike dhe që i mundëson mbajtësit të kryejë pagesa elektronike. Ky instrument mund të ringarkohet me vlera monetare sa herë është e nevojshme.

j) PIN (Numri personal i identifikimit) – është kodi numerik, që shërben për të verifikuar identitetin e mbajtësit. Në transaksionet elektronike ai konsiderohet si një ekuivalent i një nënshkrimi të autorizuar.

k) Emetues – është banka dhe/ose dega e bankës së huaj e licencuar nga Banka e Shqipërisë, që në bazë të kontratës i lëshon mbajtësit për përdorim, IPE-n.

l) Pranues – është banka dhe/ose dega e bankës së huaj, e licencuar nga Banka e Shqipërisë, që në bazë të kontratës me tregtarin pranon pagesat elektronike të iniciuara nga mbajtësi nëpërmjet IPE-ve dhe të realizuara te tregtari, nëpërmjet POS/EFTPOS ose virtual POS. Pranuesi mund të jetë njëkohësisht edhe emetues, dhe e anasjella.

m) Mbajtës – është personi, i cili në bazë të kontratës përkatëse me emetuesin mban IPE-n.

n) Tregtar – është personi fizik ose juridik, i cili në bazë të kontratës së lidhur me pranuesin, pranon pagesat me IPE-në nëpërmjet përdorimit të një pajisjeje POS/EFTPOS/virtual POS.

o) ATM (Automated Teller Machine) – është një pajisje elektromekanike, e cila bën të mundur tërheqjen ose depozitimin e parasë *cash*, pagesa të shërbimeve, transferim fondesh ndërmjet llogarive, nxjerrje llogarie etj. ATM-të operojnë si në regjim *online*, ku baza e të dhënave aksesohet në kohë reale, ashtu edhe në regjim *offline*.

p) Terminal POS (POS/EFTPOS) – është pajisja që bën të mundur përdorimin e kartave bankare në një pikë shitjeje. Informacioni për pagesën merret nëpërmjet faturave letër nga terminalët mekanike ose elektronike. Në rastin e dytë, ku njëkohësisht bëhet edhe transmetimi elektronik i informacionit, termi i referohet një “transferimi elektronik fondesh në një pikë shitjeje” EFTPOS (Electronic Fund Transfer Point of Sale).

q) Terminal virtual POS (virtual POS) – është pajisja e ngjashme në shërbime me terminalin POS, e cila mundëson kryerjen e transaksioneve nëpërmjet internetit ose telefonave, me anë të kartave bankare që punojnë në regjim *online*.

r) Regjim *online* – është regjimi në të cilin transaksionet që kryhen me IPE-në nëpërmjet mjeteve elektroteknike të komunikimit midis sistemit ku kryhet ky transaksion dhe sistemit autorizues të emetuesit të kartës ose operatorit të shërbimit të saj, miratohen menjëherë nga ky i fundit duke bllokuar fondet në llogarinë e mbajtësit të IPE-s.

s) Regjim *offline* – është regjimi në të cilin procesimi dhe miratimi i një transaksioni me IPE-në në një terminal, bëhet pa kontaktuar ndërkohë emetuesin.

t) Agjent/shtëpi klerimi – është institucioni/njësia që llogarit pozicionet shumëpalëshe neto të pagesave me karta bankare dhe përgatit kërkesën për shlyerje në sistemin AIPS.

2. Në këtë rregullore fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjellas, kurdoherë që një gjë e tillë është e nevojshme nga përmbajtja e dispozitës ose konteksti.

3. Termat në gjininë mashkullore nënkuptojnë dhe gjininë femërore dhe anasjellas.

Neni 5

Llojet e IPE-ve

1. IPE-në janë instrumentet e pagesave, të cilat bëjnë të mundur aksesimin e fondeve në një llogari bankare apo të parave të regjistruara ose të ruajtura elektronikisht, dhe që mundësojnë kryerjen e veprimeve si: depozitim/tërheqje *cash*-i, kryerje pagesash dhe/ose transfertash, vendosje depozitash, rimbushje me vlerë monetare etj., nëpërmjet mjeteve elektronike dhe teknike.

2. IPE-t klasifikohen si më poshtë:

a) instrumente të pagesave me akses në distancë, që i lejojnë mbajtësit të aksesojë fonde financiare në llogarinë e tij bankare nëpërmjet përdorimit të mjeteve elektronike dhe teknike, si:

i) karta bankare; dhe

- ii) shërbime të tjera elektronike bankare;
- b) instrumente të parasë elektronike.

KREU II
STANDARDET E TRANSPARENCËS DHE TË MBROJTJES SË KLIENTIT LIDHUR ME
KUSHTET, RREGULLAT DHE PROCEDURAT E KRYERJES SË PAGESAVE NËPËRMJET
IPE-VE

NËNKREU I
MARRËDHËNIET PËR EMETIMIN DHE PËRDORIMIN E IPE-S

Neni 6

Krijimi i marrëdhënieve për emetimin dhe përdorimin e IPE-s

Marrëdhëniet për emetimin dhe përdorimin e IPE-s krijohen dhe përcaktohen nëpërmjet kontratës së lidhur me shkrim midis emetuesit dhe mbajtësit.

Neni 7

Kushtet për transparencën ndaj mbajtësit të IPE-s

1. Bankat dhe/ose degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë të cilat emetojnë IPE, janë të detyruara të zbatojnë kërkesat për transparencën ndaj mbajtësit si më poshtë:

a) kontrata për mbajtjen e IPE-s hartohet në gjuhën shqipe, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;

b) para nënshkrimit të kontratës, emetuesi i paraqet mbajtësit të mundshëm të IPE-s të gjitha kushtet e kontratës duke e sqaruar për të drejtat dhe detyrimet reciproke. Kontrata për mbajtjen e IPE-s, duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

i) palët në kontratë;

ii) llojin e IPE-s të emetuar, llojin e pajisjes/mjetit ku mund të përdoret;

iii) llojet e transaksioneve që mund të kryhen me IPE-n;

iv) kohëzgjatjen e periudhës së përdorimit ose afatin e vlefshmërisë së IPE-s;

v) pengesat që mund të ndodhin gjatë kryerjes së transaksioneve;

vi) procedurat e aplikueshme të sigurisë dhe detyrimet e palëve në kontratë;

vii) periudhën brenda së cilës mbajtësi duhet të shlyejë detyrimet që lindin nga transaksionet me IPE-n;

viii) llojin dhe masën e tarifave dhe komisioneve që lidhen me përdorimin e IPE-s, si dhe kushtet për ndryshimin e tyre;

ix) rregullat për kryerjen e transaksioneve me monedhë të huaj, si dhe kushtet për ndryshimin e tyre;

x) rregullat për llogaritjen e normave të interesit, nëse ato aplikohen për IPE-n e emetuar;

xi) të drejtën për të paraqitur reklamime në lidhje me IPE, si dhe procedurat e paraqitjes së tyre;

xii) kushtet dhe afatet në lidhje me rinovimin e kontratës;

xiii) mënyrën, afatin e lajmërimit, kushtet për zgjidhjen e kontratës; dhe

xiv) procedurat dhe pasojat në rastet e humbjes, shkatërrimit, keqpërdorimit, grabitjes dhe/ose falsifikimit/kopjimit të IPE-s;

c) kontratës i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:

i) lista me vlerën e kufijve të lejuar për të kryer transaksione, tarifave, komisioneve dhe normat e interesit të aplikueshme, si dhe referencë për datën e kuotimit të normave të kursit të këmbimit të aplikueshme për përdorim të IPE-s, brenda dhe jashtë vendit; dhe

ii) lista me vendet e përdorimit të IPE-s, si dhe një përshkrim me shkrim, i mënyrës së përdorimit të IPE-s dhe të pajisjeve ku ajo përdoret.

2. Emetuesi i dorëzon mbajtësit IPE-n vetëm pasi të jetë siguruar se klienti është informuar dhe sqaruar mbi kushtet e kontratës dhe të drejtat e detyrimit reciproke, si dhe pas nënshkrimit të kontratës së hartuar sipas këtij neni.

Neni 8

Kërkesat për emetimin dhe përdorimin e IPE-s

1. Subjektet e kësaj rregulloreje kanë të drejtë të emetojnë IPE dhe të ofrojnë shërbimin e pagesave elektronike përmes IPE-ve, vetëm pasi të jenë licencuar nga Banka e Shqipërisë për këtë qëllim.

2. Subjektet e kësaj rregulloreje që kërkojnë të emetojnë një lloj të ri IPE-je, përpara ofrimit të shërbimeve të pagesave elektronike me të, njoftojnë me shkrim Departamentin e Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, në përputhje me rregulloren “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”.

3. Banka e Shqipërisë jep pëlqimin për emetimin e një lloji të ri IPE-je, si dhe autorizon ofrimin e shërbimit të pagesave elektronike me të, vetëm pasi sigurohet se subjekti përkatës, plotëson kushtet e përcaktuara në rregulloren “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”.

4. Për emetimin e IPE-ve, emetuesi duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) t'i mundësojë mbajtësit kryerjen e transaksioneve me IPE;

b) t'i dorëzojë në zarf të mbyllur PIN-in vetëm mbajtësit dhe askujt tjetër;

c) t'i japë të dhëna konfidenciale mbi transaksionet bankare vetëm mbajtësit, në mbështetje të akteve juridike për ruajtjen e të dhënave dhe të sekretit bankar;

d) të mos emetojë instrumente pagese nëse mbajtësi nuk ia kërkon këtë, përveç rasteve kur ai zëvendëson një IPE (kartë bankare) të përdorur nga mbajtësi;

e) të regjistrojë çdo transaksion dhe të ruajë regjistrimet për një periudhë kohe të mjaftueshme, në mënyrë që të mundësohet identifikimi i transaksioneve të realizuara dhe ndreqja e gabimeve në rastet e përcaktuara në kontratë;

f) me publikimin e ndryshimit të normave të interesit, të njoftojë njëkohësisht me shkrim edhe mbajtësin;

g) të vërë në dispozicion të mbajtësit, çdo informacion mbi transaksionet e tij, me kërkesë të këtij të fundit;

h) të njoftojë me shkrim mbajtësin për propozimet e ndryshimeve të dispozitave të kontratës;

i) t'i ofrojë mbajtësit mundësinë e njoftimit në lidhje me humbjen, grabitjen, keqpërdorimin dhe/ose shkatërrimin e IPE-s, përgjatë 24 orëve të ditës, 7 ditë të javës, me anë të mjeteve të komunikimit në dispozicion;

j) të identifikojë personin që bën njoftimin sipas shkronjës “i”, me qëllim që të sigurohet se ai është vetë mbajtësi i IPE-s;

k) të regjistrojë të plotë, marrjen e njoftimit për rastet e parashikuara në shkronjën “i” të këtij neni, duke përfshirë marrjen e të dhënave në lidhje me numrin identifikues të IPE-s, personin që bën njoftimin, datën dhe orën e saktë të marrjes së njoftimit, si dhe rrethana të tjera shtesë;

l) me marrjen e njoftimit sipas shkronjës “i” dhe identifikimin e personit sipas shkronjës “j” të këtij neni, të ndërmarrë menjëherë të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar përdorimin e mëtejshëm të IPE-s, edhe në rastet kur mbajtësi mund të ketë vepruar me neglizhencë të plotë ose me mashtrim; dhe

m) zbaton kërkesat e ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave” gjatë procesit të emetimit dhe monitorimit të përdorimit të IPE-s.

5. Emetuesi publikon në ambientet ku zhvillon aktivitetin dhe/ose nëpërmjet masmedias, informacion falas mbi:

a) normat e interesave të aplikueshëm; dhe

b) vlerën e tarifave dhe komisioneve të aplikueshme dhe në mënyrë të veçantë, mbi komisionet që i ngarkohen mbajtësit kur IPE përdoret në pajisjet e ofruara nga pranues të ndryshëm

nga emetuesi.

6. Emetuesi i siguron çdo muaj mbajtësit informacion në lidhje me çdo transaksion të kryer me anë të IPE-s. Ky informacion duhet të jetë me shkrim, kur është e mundur përcillet edhe me anë të mjeteve elektronike, dhe duhet të përmbajë:

a) një referencë që të lejojë mbajtësin të identifikojë transaksionet, përfshirë informacion në lidhje me tregtarin dhe/ose vendin ku është realizuar transaksioni, si dhe llojin, datën, orën dhe numrin e referencës së transaksionit të kryer;

b) shumën e transaksionit me të cilën është debituar llogaria e mbajtësit duke përfshirë edhe vlerën e transaksionit në valutën origjinale;

c) normat e interesit, komisionet dhe/ose tarifat e mundshme për çdo transaksion, në rast se ka të tilla; dhe

d) shërbimet e reja që mund të ofrojnë në lidhje me IPE-n.

Neni 9

Standardet për mbrojtjen e klientit, mbajtës i IPE-s

1. Me qëllim mbrojtjen e interesave të mbajtësit, emetuesi duhet:

a) të regjistrojë në mënyrë korrekte dhe të evidentojë në llogaritë bankare të mbajtësit çdo transaksion të kryer me IPE nga mbajtësi; dhe

b) të sigurojë shmangien e pengesave teknike apo mangësive të tjera, për kryerjen normale të transaksioneve me IPE-n.

2. Emetuesi, në kontratën sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje, sigurohet të përfshijë në përmbajtjen e saj kushtet për mbrojtjen e mbajtësit, sipas të cilave ky i fundit duhet:

a) të përdorë IPE-n në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në kontratë dhe të kujdeset për të;

b) të mbajë sekret PIN-in ose fjalëkalimin e tij, dhe të marrë të gjitha masat për të mos lejuar aksesin e një personi tjetër;

c) të njoftojë menjëherë emetuesin në rast se ndodh të paktën një nga ngjarjet e mëposhtme:

i) IPE shkatërrohet, keqpërdoret, humbet, grabitet, falsifikohet/kopjohet;

ii) vëren ndonjë abuzim, mashtrim në lidhje me PIN-in/fjalëkalimin e tij, që bën të mundur aksesin e personave të tretë në llogarinë e tij;

iii) transaksioni me IPE, është kryer pa marrë miratimin nga mbajtësi;

iv) vëren një gabim apo mospërputhje në llogarinë e tij pranë emetuesit;

d) të mos e shkruajë PIN-in/fjalëkalimin e tij në një vend të dukshëm dhe që i jep mundësi një personi të tretë ta lexojë atë;

e) të mos anulojë një urdhër që ka iniciuar me anë të IPE-s, përveç rasteve kur në urdhër nuk është përcaktuar shuma;

f) të japë të dhëna të plota dhe të sakta për qëllime identifikimi; dhe

g) të njoftojë menjëherë emetuesin për ndryshimin e të dhënave personale të tij.

3. Njoftimi për rastet e parashikuara në pikën 2, shkronja "c" të këtij neni bëhet me mjete të ndryshme të komunikimit, sipas përcaktimeve të kontratës.

4. Mbajtësi mbart detyrimin financiar për humbjet e konstatuara nga humbja apo vjedhja e IPE-s, deri në momentin e bërjes së njoftimit. Pas njoftimit, mbajtësi nuk mbart më detyrim financiar për humbjet e konstatuara, përveç rasteve kur ai vepron në kushte mashtrimi.

5. Përveç sa parashikohet në pikën 4 të këtij neni, në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni, mbajtësi nuk mbart detyrim financiar në rastet kur IPE është përdorur pa praninë fizike dhe/ose identifikimin elektronik të vetë instrumentit, përveç rasteve kur ai vepron në kushte mashtrimi/neglizhence. Përdorimi i një kodi konfidencial apo i një mjeti tjetër të ngjashëm identifikues, nuk është i mjaftueshëm për t'i njohur detyrimin mbajtësit.

6. Në vijim të sa parashikuar më lart në këtë nen, emetuesi mbulon dëmet financiare të mbartura nga mbajtësi, në rastet kur:

a) transaksioni nuk është ekzekutuar ose është ekzekutuar gabim, përfshirë edhe rastet kur transaksioni është kryer në terminale të autorizuara për përdorim nga mbajtësi, por që nuk janë në

kontrollin direkt të emetuesit; dhe

b) transaksionet nuk janë autorizuar nga mbajtësi, si dhe për çdo gabim ose pasaktësi të shkaktuar nga emetuesi në lidhje me mirëmbajtjen e llogarisë së mbajtësit.

7. Mbulimi i dëmeve financiare sipas pikës 6 të këtij neni, përfshin:

a) vlerën e transaksionit të paekzekutuar ose të ekzekutuar gabim, në rast se ka të tilla, si dhe interesat përkatëse; dhe

b) shumën e nevojshme për të rikthyer tepricën e llogarisë së mbajtësit në gjendjen e mëparshme, para ndodhjes së transaksionit të paautorizuar.

NËNKREU II MARRËDHËNIET PËR PRANIMIN E PAGESAVE ME IPE

Neni 10

Krijimi i marrëdhënieve për prezantimin e pagesave me IPE

Marrëdhëniet për pranimin e pagesave me IPE krijohen dhe përcaktohen nëpërmjet kontratës midis pranuesit dhe tregtarit.

Neni 11

Kushtet për transparencën ndaj tregtarit

1. Bankat dhe/ose degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat pranojnë pagesa me IPE, janë të detyruara të zbatojnë kërkesat për transparencën ndaj tregtarit, si më poshtë:

a) kontrata për pranimin e pagesave me IPE hartohet në gjuhën shqipe, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;

b) para nënshkrimit të kontratës, pranuesi i paraqet tregtarit të gjitha kushtet e kontratës duke e sqaruar për të drejtat dhe detyrimet reciproke. Kontrata duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

i) palët në kontratë;

ii) llojin e IPE-s që do të përdoret për kryerjen e transaksioneve të tregtarit;

iii) procedurat e aplikueshme, përfshirë procedurat e sigurisë dhe detyrimet e tregtarit gjatë kryerjes së transaksioneve;

iv) periudhën dhe mënyrën e kryerjes së pagesës nga pranuesi për tregtarin;

v) rastet e refuzimit të pranimit të kryerjes së pagesës me IPE;

vi) rastet e mbajtjes së IPE-s;

vii) procedurat në lidhje me të drejtën e ushtrimit të ankimeve;

viii) kushtet dhe afatet në lidhje me rinovimin e kontratës; dhe

ix) mënyrën, afatin e lajmërimit dhe kushtet për zgjidhjen e kontratës.

2. Pranuesi, për pranimin e pagesave me IPE, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të hapë llogari bankare në emër të shoqërisë apo tregtarit;

b) të bëjë të mundur pranimin dhe kryerjen e transaksioneve me IPE;

c) të regjistrojë çdo transaksion dhe të ruajë regjistrimet për një periudhë kohe të mjaftueshme, në mënyrë që të mundësohet identifikimi i transaksioneve të realizuara dhe ndreqja e gabimeve në rastet e përcaktuara në kontratë;

d) të zbatojë procedurat e sigurisë për garantimin e kryerjes së transaksioneve me IPE;

e) të zbatojë aktet juridike për ruajtjen e të dhënave dhe të sekretit bankar; dhe

f) të njoftojë me shkrim tregtarin për propozimet e ndryshimeve të dispozitave të kontratës.

3. Kontrata nuk përmban asnjë dispozitë ndaluese për tregtarin, që të përdorë vetëm sistemin e një pranuesi.

4. Dispozita urdhëruese mund të lejohen vetëm për aspektet teknike të mirëfunksionimit të sistemit të pagesave.

Neni 12

Kërkesat për ofrimin e shërbimit të pranimit të pagesave me IPE

Pranuesi, përpara ofrimit për herë të parë të një pajisjeje elektronike për pranimin e pagesave me IPE, njofton me shkrim Departamentin e Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë.

Neni 13

Standardet për mbrojtjen e klientit, mbajtës i IPE-s

Pranuesi, në kontratën sipas nenit 11 të kësaj rregulloreje, sigurohet të përfshijë në përmbajtjen e saj disa kushte për mbrojtjen e mbajtësit, sipas të cilave tregtari:

a) mund t'i kërkojë mbajtësit paraqitjen e një dokumenti identifikimi, në rast dyshimi për identitetin e tij, përpara pranimit të një pagese me IPE;

b) duhet të refuzojë pranimin e një pagese me IPE sipas nenit 11, pika 1, shkronja "b", nën-pika "v" të kësaj rregulloreje, në rastet e mëposhtme:

i) pavlefshmërisë së IPE-s;

ii) njoftimit për grabitje apo humbje të një IPE;

iii) mospërputhjes së nënshkrimit të autorizuar në IPE me nënshkrimin e dokumentit të transaksionit apo mjetit të identifikimit;

iv) refuzimit nga ana e mbajtësit për të treguar një dokument identifikimi ose nëse tregtari identifikon që një person i paautorizuar përdor IPE-n;

v) pamundësisë së marrjes së konfirmimit për kryerjen e transaksionit;

vi) mungesës ose pasaktësisë së të paktën një elementi sigurie të IPE-s;

vii) dyshimeve për një falsifikim/kopjim të IPE-s; dhe

viii) mungesës së nënshkrimit të autorizuar në IPE, nëse kjo është e domosdoshme për efekt vlefshmërie;

c) mund të mbajë IPE-n, sipas nenit 11, pika 1, shkronja "b", nën-pika "vi", të kësaj rregulloreje, në rastet e mëposhtme:

i) lajmërimit për grabitje apo humbje të IPE-s;

ii) mospërputhjes së nënshkrimit në IPE me nënshkrimin e faturës së blerjes;

iii) përdorimit të IPE-s nga një person i paautorizuar;

iv) marrjes së një urdhri nga pranuesi për mbajtjen e IPE-s; dhe

v) konstatimit se të paktën një nga elementet e sigurisë nuk është i saktë;

d) duhet të kujdeset për procedurat e sigurisë, sipas nenit 11, pika 1, shkronja "b", nën-pika "iii" të kësaj rregulloreje dhe të mos bëjë publike të dhënat personale dhe numrin e kartës së mbajtësit, personave të paautorizuar, si dhe të mos lejojë përdorim të gabuar/pasaktë apo falsifikim/kopjim të IPE-s;

e) duhet të pranojë pagesat e kryera nëpërmjet IPE-ve, brenda të njëjtëve terma dhe kushte si për pagesat *cash*, dhe nuk duhet të aplikojë ndaj mbajtësit komision apo tarifa shtesë, mbi çmimin e pagesave të kryera nëpërmjet tyre.

Neni 14

Parevokueshmëria e urdhrit

Urdhri i dhënë nga mbajtësi i IPE-s për autorizimin e një transaksioni mund të kthehet vetëm para autorizimit të tij. Pas autorizimit të transaksionit nga mbajtësi, urdhri është i pakthyeshëm përveç rasteve kur termat për përdorimin e IPE-s, parashikojnë ndryshe.

KREU III
INSTRUMENTET E PAGESAVE ME AKSES NË DISTANCË

NËNKREU I
KARTAT BANKARE

Neni 15
Llojet e kartave bankare

1. Kartat bankare të pagesave mund të jenë në formën e:
 - a) kartave *cash* – që mundësojnë përdorimin vetëm në ATM ose në makinat e *cash*-it dhe që i lejojnë mbajtësit vetëm të tërheqë *cash*;
 - b) kartave të debitit – që i lejojnë mbajtësit të autorizuar të ketë akses në llogarinë e tij pranë emetuesit, për të kryer blerje me fondet e disponueshme në këtë llogari dhe/ose për të tërhequr para *cash*, në rastet kur kjo kartë është e kombinuar me kartën me funksion *cash*-i;
 - c) kartave me debitim të vonuar – që janë të ngjashme me kartat e debitit, përveç faktit që shlyerja e pagesës në llogari bëhet pas një periudhe të caktuar kohe sipas kushteve të përcaktuara në kontratë;
 - d) kartave të kreditit – që i japin mundësinë mbajtësit të saj të përdorë një linjë krediti. Nëpërmjet saj mbajtësi mund të bëjë blerje dhe/ose të tërheqë *cash* nën një kufi të paracaktuar. Sasia e lejuar e kreditit duhet të shlyhet e plotë, në fund të një periudhe të caktuar ose mund të shlyhet pjesërisht dhe e shtyrë në kohë, në përputhje me termat e përcaktuar në kontratë;
 - e) *charge cards* – që janë të ngjashme me kartat e kreditit, përveç faktit se shlyerja e kredisë bëhet e plotë dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratë.
2. Kartat bankare mund të kenë edhe kombinim funksionesh të formave të mësipërme.

Neni 16
Karta shitesë

Me pëlqimin e titullarit të llogarisë dhe/ose mbajtësit të kartës kryesore, emetuesi emeton kartë shitesë, kontrata e së cilës nënshkruhet edhe nga një person i tretë, mbajtës i kartës shitesë.

Neni 17
Transaksionet që kryhen me kartat bankare

1. Transaksionet që mund të kryhen me kartat bankare janë si më poshtë:
 - a) tërheqje dhe depozitim *cash*-i nga/në një terminal ATM;
 - b) pagesa e të mirave dhe shërbimeve, si dhe tërheqje *cash*-i nga një terminal POS/EFTPOS;
 - c) pagesa e të mirave dhe shërbimeve, si dhe transferim fondesh ndërmjet llogarive nga një terminal virtual POS/EFTPOS;
 - d) pagesa të shërbimeve nga terminalet ATM;
 - e) transferim fondesh ndërmjet llogarive nga një terminal ATM;
 - f) transferim të gjendjes së llogarisë rrjedhëse në një depozitë, nëpërmjet një terminali ATM; dhe
 - g) printim të gjendjes së llogarisë apo nxjerrje e pasqyrës së veprimeve të fundit në llogari, si dhe kryerjen e transaksioneve të tjera jopagesa për shembull, ndryshim PIN-i pranë një ATM-je etj.
2. Pranuesit bëjnë të mundur që transaksionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, të kryhen në të gjitha POS/EFTPOS dhe ATM-të e ofruara dhe financuara nga to, duke përdorur karta bankare të emetuara në territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë tij, në përputhje me marrëveshjet me shoqëritë ndërkombëtare të kartave.

Neni 18

Pajisjet për përdorimin e IPE-ve

1. Në pajisjen ku kryhen transaksionet me IPE apo në ambiente të dukshme rreth saj, vendosen:

- a) logoja e bankës pranuese; dhe
- b) blogot e llojeve të kartave të pranuar nga kjo pajisje.

2. Pranuesi i vendos pajisjet në vende të tilla ku mbajtësit ose një grup i caktuar mbajtësish, mund të kenë akses të lirë dhe të sigurt.

Neni 19

Numri personal i identifikimit (PIN)

1. PIN është numri personal që identifikon çdo mbajtës, që përdor kartën bankare.

2. Emetuesi pajis me PIN çdo mbajtës të një karte, i cili përmban të paktën katër shifra që e identifikojnë atë. PIN, i dorëzohet i mbyllur në një zarf mbajtësit në momentin e dhënies së kartës bankare.

3. Karta bankare mund të përdoret vetëm me PIN-in e krijuar posaçërisht për të. Nëse mbajtësi e harron PIN-in e tij, emetuesi krijon një PIN të ri për atë kartë, brenda afatit të përcaktuar në kontratë ose lëshon një kartë të re me një PIN të ri.

4. PIN-i mund të përdoret në tastierën e çdo terminali POS/EFTPOS apo ATM që pranon kartën bankare, për të kryer transaksionet e përcaktuara në nenin 17 të kësaj rregulloreje. Në varësi të llojit të emetuesit/pranuesit, varet edhe përdorimi i PIN-it apo jo në POS/EFTPOS.

5. Mbajtësi mund të ndryshojë PIN-in e tij nëpërmjet një terminali ATM, në një PIN të ri për të cilin vetëm ai ka dijeni, në rastet kur banka e tij ia ofron këtë shërbim.

Neni 20

Pronësia e kartës dhe kthimi i saj tek emetuesi

1. Karta e lëshuar për përdorim nga mbajtësi është në pronësi të emetuesit.

2. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për mbajtjen e kartës bankare, mbajtësi ia kthen kartën emetuesit brenda afatit të rënë dakord në kontratë.

Neni 21

Monedha

Tërheqjet apo pagesat me kartë bankare me anë të terminaleve ATM apo në POS/EFTPOS në territorin e Republikës së Shqipërisë, kryhen në monedhë kombëtare ose të huaj, në përputhje me marrëveshjet e lidhura me shoqëritë ndërkombëtare të kartave.

Neni 22

Shlyerja e pagesave me kartë bankare

1. Shlyerja e pagesave në lekë/valutë me kartë bankare të emetuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, kryhet nëpërmjet shoqërive ndërkombëtare të kartave dhe/ose bankave korrespondente të huaja, në përputhje me marrëveshjet dy ose shumëpalëshe të lidhura ndërmjet emetuesit/pranuesit me shoqëritë ndërkombëtare të kartave.

2. Në vijim të marrëveshjeve të veçanta të emetuesve/pranuesve me shoqëri ndërkombëtare të kartave, në rastet kur këto shoqëri janë pranuar si agent/shtëpi klerimi nga Banka e Shqipërisë, shlyerja e pagesave në lekë, të kryera brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me kartë bankare të emetuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, kryhet nëpërmjet llogarisë së shlyerjes që çdo emetues/pranues ka në sistemin AIPS, pranë Bankës së Shqipërisë. Për llogaritja e pozicioneve neto të pagesave në lekë me karta bankare ndërmjet emetuesve/pranuesve, bëhet nga agjenti/shtëpia e

klerimit dhe dërgohet në Bankën e Shqipërisë për shlyerje në sistemin AIPS.

NËNKREU II SHËRBIME TË TJERA ELEKTRONIKE BANKARE

Neni 23

Llojet

1. Shërbimet e tjera elektronike bankare, mund të jenë në formën e *home banking*, *phone banking*, *internet banking*.

2. Citimi i llojeve të shërbimeve sipas pikës 1 të këtij neni, nuk ka karakter shterues dhe varet nga zhvillimet e mëtejshme të teknologjisë.

Neni 24

Standardet e transparencës së emetuesit të shërbimeve të tjera elektronike bankare

1. Përveç sa përcaktuar në kontratën për emetimin e IPE-s, sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje, emetuesi vë në dispozicion të mbajtësit informacion me shkrim në lidhje me:

a) rregullat e identifikimit elektronik të mbajtësit;

b) rregullat që ndiqen nga mbajtësi në lidhje me dhënien e urdhrave për kryerjen e transaksioneve ose për përdorimin e shërbimeve të tjera, të specifikuara në kontratë.

2. Emetuesi i krijon mundësinë mbajtësit të aksesojë fondet në llogarinë e tij, si dhe të kryejë transaksione me anë të aplikimeve të pagesave elektronike në shërbimet elektronike bankare, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit, si telefon, internet, celular etj.

3. Mbajtësi, në përputhje me termat e përcaktuar në kontratë, urdhëron emetuesin për debitimin e llogarisë së tij me shumën e transaksionit të ekzekutuar, si dhe për tarifat dhe komisionet e aplikueshme nga emetuesi ose angazhohet të paguajë shumën për të cilën i detyrohet bankës, brenda një periudhe të caktuar kohe.

4. Emetuesi i garanton mbajtësit, sigurinë e nevojshme në lidhje me transaksionet e realizuara nëpërmjet mjeteve të komunikimit, të përcaktuara në kontratë.

5. Emetuesi informon menjëherë mbajtësin në rastet e refuzimit ose të moskryerjes së transaksionit të urdhëruar nga ky i fundit, kur refuzimi/moskryerja rrjedh për shkaqe që nuk varen nga emetuesi.

KREU IV

INSTRUMENTET E PARASË ELEKTRONIKE

Neni 25

Paraja elektronike

Paraja elektronike është zëvendësuese e kartëmonedhave dhe e monedhave, dhe ka karakteristikat e mëposhtme:

a) është vlerë monetare që përfaqëson një detyrim të emetuesit kundrejt mbajtësit;

b) ruhet në një pajisje elektronike në formën e një karte chip apo memorie kompjuteri;

c) emetohet në shkëmbim të një shume parash, e cila nuk mund të jetë më e ulët se vlera monetare e parasë elektronike të emetuar;

d) emetimi nuk kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e një llogarie bankare;

e) i lejon mbajtësit të kryejë pagesa dhe transferta elektronike në shuma të kufizuara, *online* dhe *offline*; dhe

f) pranohet si mjet pagese elektronike nga të tretët.

Neni 26

Llojet e instrumenteve të parasë elektronike

Instrumentet e parasë elektronike mund të jenë në formën e:

- a) kartave të parapaguara, të cilat paraqiten si karta plastike me fuqi blerëse; dhe
- b) produkteve të parapaguara kompjuterike, të cilat konsistojnë në programe të veçanta që i mundësojnë mbajtësit, transferimin e parasë elektronike nëpërmjet rrjeteve elektronike të komunikimit.

Neni 27

Emetuesi i instrumentit të parasë elektronike dhe marrëdhëniet ndërmjet palëve

1. Në zbatim të kësaj rregulloreje, emetuese të instrumenteve të parasë elektronike janë vetëm bankat dhe/ose degët e bankave të huaja.
2. Marrëdhëniet për emetimin e instrumenteve të parasë elektronike krijohen dhe përcaktohen nëpërmjet kontratës midis emetuesit dhe mbajtësit.
3. Marrëdhëniet për pranimin e instrumenteve të parasë elektronike krijohen dhe përcaktohen nëpërmjet kontratës midis pranuesit dhe tregtarit.
4. Kufijtë minimalë dhe maksimalë, brenda të cilëve emetohet paraja elektronike, përcaktohen në kontratën e emetimit të parasë elektronike.
5. Emetuesi është përgjegjës kundrejt mbajtësit, në rastet kur ky i fundit ka pësuar humbje ose dëmtim të parasë elektronike, si pasojë e mosfunksionimit të pajisjes së autorizuar nga emetuesi, për pranimin e instrumentit të parasë elektronike si mjet pagese.
6. Emetuesi informon mbajtësin, në lidhje me të paktën 5 (pesë) transaksionet e fundit të kryera me instrumentin e parasë elektronike, si dhe me tepricën e fondeve të mbetura dhe të ruajtura në të.
7. Informacioni i përcaktuar në pikën 6 të këtij neni, vihet në dispozicion të mbajtësit me kërkesë të tij.

Neni 28

Pronësia e parasë elektronike

Mbajtësi është pronari legjitim i fondit që i paguan emetuesit për mbajtjen dhe/ose përdorimin e parasë elektronike.

Neni 29

Dallimi nga depozita

1. Fondi i paguar për mbajtjen dhe/ose përdorimin e parasë elektronike, nuk konsiderohet depozitë, nëse fondi i marrë kthehet po në atë moment në para elektronike nga ana e emetuesit.
2. Emetuesi nuk aplikon normat e interesit mbi fondet sipas pikës 1 të këtij neni dhe nuk i përfshin këto fonde në llogaritjen e rezervës minimale të detyrueshme të tij.

Neni 30

Kohëzgjatja e parasë elektronike

1. Kohëzgjatja e parasë elektronike përcaktohet në kontratën e emetimit të parasë elektronike.
2. Në përfundim të afatit të përcaktuar në kontratë, sipas pikës 1 të këtij neni, instrumenti i parasë elektronike shkatërrohet.

Neni 31
Kompensimi

1. Përgjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, emetuesi me kërkesë të mbajtësit dhe në bazë të kushteve dhe afateve të përcaktuara në kontratën e emetimit të parasë elektronike, kompenson me *cash* apo nëpërmjet një transferte *jocash*, paranë elektronike të ruajtur në instrumentin e parasë elektronike, me vlerën nominale.

2. Emetuesi përcakton në kontratë sipas pikës 1 të këtij neni, kufirin minimal për kompensim të parasë elektronike, i cili në çdo rast nuk është më shumë se ekuivalenti i 5 (pesë) eurove në ALL.

Neni 32
Humbja dhe/ose vjedhja

Në rastet e verifikimit të humbjes dhe/ose vjedhjes së parasë elektronike, emetuesi i kthen mbajtësit fondet e mbetura, në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën ndërmjet palëve.

KREU V
RAPORTIMI DHE MBROJTJA E INFORMACIONIT GJATË PËRDORIMIT TË NJË IPE

Neni 33
Raportimi pranë Bankës së Shqipërisë

Emetuesi/pranuesi, brenda datës 15 të çdo muaji, raporton pranë Bankës së Shqipërisë, sipas formatit të përcaktuar në metodologjinë e raportimit të instrumenteve të pagesave, informacionin e mëposhtëm:

- a) numrin dhe llojin e IPE-ve të emetuara;
- b) numrin, llojin dhe vlerën e transaksioneve të kryera me IPE;
- c) numrin e tregtarëve me të cilët pranuesi ka lidhur kontratë për pranimin e pagesave me IPE;
- d) numrin e terminaleve ATM dhe POS/EFTPOS që ata disponojnë;
- e) përpjekjet e regjistruara për shmangie apo shkelje të rregullave; dhe
- f) çdo të dhënë tjetër, të kërkuar nga metodologjia e raportimit të instrumenteve të pagesave.

Neni 34
Metodologjia e raportimit

Banka e Shqipërisë harton metodologjinë e raportimit të instrumenteve të pagesave, me qëllim mbledhjen e informacionit nga emetuesit, në funksion të vlerësimit dhe kontrollit të sistemeve të pagesave, administrimit e politikës monetare, si dhe për qëllime statistikore. Metodologjia e raportimit për instrumentet e pagesave përgatitet nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe miratohet nga Administratori përkatës në Bankën e Shqipërisë.

Neni 35
Mbrojtja e të dhënave personale

1. Informacioni në lidhje me transaksionet e pagesave mbrohet dhe trajtohet sipas legjislacionit në fuqi dhe emetuesi/pranuesi mban dhe ruan konfidencialitetin e të dhënave të mbajtësit/tregtarit që përdor/pranon IPE-n. Ky detyrim është pjesë e kontratës ndërmjet palëve.

2. Informacioni i transmetuar në momentin e pagesës, në asnjë rast, nuk duhet të cenohet mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Emetuesi/pranuesi merr masat e nevojshme në mënyrë që askush tjetër veç tij, të mos ketë mundësi t'i lexojë të dhënat personale të mbajtësit gjatë përdorimit të IPE-s.

4. Informacioni personal i mbajtësit, në lidhje me veprimet e tij, mund të bëhet publik vetëm në rastet e lejuara dhe të përcaktuara shprehimisht nga legjislacioni në fuqi.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 36 **Sanksionet**

1. Banka e Shqipërisë, pas realizimit të procesit të mbikëqyrjes, në rast të vërtetimit të mosrespektimit dhe/ose shkeljeve të dispozitave të kësaj rregulloreje nga ana e bankave dhe/ose degëve të bankave të huaja, ka të drejtë të vendosë një ose disa nga masat mbikëqyrëse, masat parandaluese ose masat ndëshkimore të përcaktuara në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë ditë) pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
ARDIAN FULLANI**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- | | |
|--|-----------|
| 1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË | 600 lekë |
| 2. REGJISTRAT E NOTERISË | 1000 lekë |

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë
• Vendime të Gjykatës Kushtetuese	700 lekë
• Vendime të Gjykatës së Lartë	1000 lekë
• Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil	200 lekë
• Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave	273 lekë
• Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)	

Hyri në shtyp më 15.2.2008
Doli nga shtypi më 17.2.2008

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2008

Çmimi 24 lekë